




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 251/2019
Datë: 12 dhjetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e 227-të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anëtarë për të shërbyer në Panelin Hetimor në lëndën Nr.AD/KGJK/10/GJTHPZ-ADGJTHP.nr.14/2019, caktohen gjyqtarët:
 - Jovica Mitrović, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-kryesuese;
 - Faton Ajvazi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj-anëtar;
 - Lidija Vuçurović, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-anëtare;
 - Behar Ymeri, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan- anëtar rezervë;
 - Prek Palushi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë, anëtar rezervë.

- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, ka themeluar Panelin Hetimor për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore, sipas nenit 11 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli përbëhet prej tre (3) gjyqtarëve, që janë zgjedhur me short dhe të cilët vijnë nga gjykatat tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që do të hetohet.

Paneli Hetimor zhvillon hetimin bazuar në nenin 12 paragrafi 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, brenda tre (3) muajve nga dita e themelimit. Në qoftë se paraqiten rrethanat të jashtëzakonshme dhe në bazë të kërkesës së panelit, Këshilli mundë t'i zgjasë mandatin panelit edhe për dy (2) muaj shtesë.

Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Arkivit.